



SAPIENZA  
UNIVERSITÀ DI ROMA



**THIRRJA E PARË PËR PJESËMARRJE NË  
KONFERENCËN E 2-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE**

***“STUDIME NDËRKULTURORE NË FUSHËN E SË  
DREJTËS, SHKENCAVE EKONOMIKE DHE  
SHOQËRORE”***

***9 MAJ, 2019***

**VENDI:**

**KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”**

**Rruga “Medar Shtylla”**

**Tiranë, SHQIPËRI**

**Web-site: [www.wisdom.edu.al](http://www.wisdom.edu.al)**

---

## ***Të nderuar kolegë,***

Në kuadër të zbatimit të projektit Erasmus +, “Cultural studies in business” ref. No. 2018 – 1- IT02-KA203-048091 me partnerë “Sapienza Universita Di Roma” – Itali; “Highers Education Institution Kumanovo”- Maqedoni; “Vilniaus Gedimino Technikos Universitetas” – Lituan; “University of Split” – Kroaci; “Universidade Beira Interior” – Portugali; si dhe organizatën “Jump associazione culturale” - Itali; kemi kënaqësinë që në emër të Kolegjit Universitar “Wisdom” dhe Institutit për Kërkim dhe Zhvillim “Wisdom”, t’Ju drejtohem dhe të kërkojmë pjesëmarrjen Tuaj në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “STUDIME NDËRKULTURORE NË FUSHËN E SË DREJTËS, SHKENCAVE EKONOMIKE DHE SHOQËRORE”. Konferenca do të zhvillohet në datë 9 Maj 2019, në mjediset e Kolegjit Universitar “Wisdom” në bashkëpunim me “UNIVERSITA DELLA CALABRIA” – Itali dhe “KOLEGJI EUROPIAN I KOSOVËS”, Prishtinë – Kosovë.

Kjo konferencë ka për qëllim të trajtojë punime kërkimore-shkencore në fushat e Shkencave Humane të tilla si Drejtësi, Psikologji, Komunikim, Ekonomi, Histori, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Politike, Marrëdhënie me Publikun, Biznes, Marketing, të Drejtat e Njeriut, Sociologji, Edukim dhe Letërsi, duke gjykuar se është e nevojshme që profesorët, kërkuesit shkencorë, studjuesit e praktikantët e së drejtës, fushës së biznesit dhe shkencave shoqërore, nga institucione të arsimit të lartë publik dhe privat brenda vendit, në rajon apo më gjerë, të japin kontributin e tyre (virtualisht ose personalisht) me ide, dije e argumenta shkencorë në funksion të zhvillimit ndërkulturor të shoqërisë, duke bashkëpunuar për të dhënë një produkt aktual që jetë një vlerë e shtuar për të ardhmen e shoqërisë civile.

Kjo konferencë ka një Bord Shkencor të përbërë nga përfaqësues të njëjësive akademike dhe profesoratit të Kolegjit Universitar “Wisdom”. Në këtë bord marrin pjesë përfaqësues nga bota akademike dhe personalitete të fushave të ndryshme në vendin tonë dhe rajon.

### ***Kriteret dhe afatet për pranim:***

1. *Abstraktet duhet të shkruhen:*
  - në gjuhët shqip dhe anglisht, në përputhshmëri me standardet shkencore,
  - të përmbajnë jo më shumë se 250 fjalë, duke përfshirë edhe fjalët kyçe (jo më shumë se pesë fjalë).
  - Shkrimi: Times New Roman, hapësira 1.5, madhësia e shkrimit 12.
2. *Pas dorëzimit, abstraktet do të vlerësohen nga Bordi Shkencor i Konferencës.*
3. *Afati i fundit i dërgimit të abstraktit: deri më Dt.20/03/2019.*
4. *Përgjigjja e pranimit të punimit, deri më Dt.03/04/2019.*
5. *Punimi i plotë shkencor të dërgohet në gjuhën shqipe ose angleze, deri më Dt.29/04/2019.*

---

*Pedagogë, kërkues shkencorë, akademikë dhe zbatues ligjorë të fushës së të drejtës, shkencave ekonomike dhe shoqërore, janë të ftuar të marrin pjesë dhe të prezantojnë studimet e tyre në lidhje me këtë temë, e cila është me mjaft rëndësi për zhvillimet aktuale të shoqërisë. Autorët duhet t'i dërgojnë punimet e tyre në formatin MS-Word, bashkëlidhur në adresën e email-it:*

*[wisdomscientificjournalwsj@yahoo.com](mailto:wisdomscientificjournalwsj@yahoo.com)*

***Punimet e pranuar nga Bordi Shkencor i Konferencës, do të botohen në librin “Conference Proceedings” (me ISBN) dhe referuesit do të marrin çertifikatën përkatëse.***

***Para dërgimit, autorët duhet të lexojnë me kujdes kriteret për pranim.***

***Vlerësohet maksimalisht nëse mund ta ndani këtë informacion me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj!***

***Me respekt.***

***Bordi Organizativ***